



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve,
Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Nr.685/8 Prot.

Tiranë, më 23/09/2016

V E N D I M
Nr.114, Datë 23.09.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT TË QARKUT TIRANË "MBI VEPRIMTARINË PËR MONITORIMIN DHE MBROJTJEN E MJEDISIT, PROCEDURËN E PRANIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT PËR REGJISTRIMIN E SUBJEKTEVE, ZBATIMIN TË LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË, ADMINISTRIMIT FINANCIAR DHE VLERËSUES".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, mbi veprimtarinë për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit, procedurën e pranimit dhe administrimit të dokumentacionit për regjistrimin e subjekteve, zbatimin të ligjshmërisë, rregullshmërisë, administrimin financiar dhe vlerësues", të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Qarkut Tiranë, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A . MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: DRM e Qarkut Tiranë, nuk ka hartuar regjistrin kadastral mjedisor manual, por vetëm atë elektronik për Qarkun nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore, e cila i shërben Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e masave me qëllim evitimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit dhe përbërësve të tij si dhe të rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve për Qarkun Tiranë (*Trajtuar në faqet 84-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1. Rekomandimi: DRM e Qarkut Tiranë të hartojë regjistrin kadastral mjedisor, manual në formë dhe përmbajtje zyrtare dhe i arkivuar krahas atij në formë digjital elektronik për Qarkun, nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore, me synim shërbimi Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e masave lidhur me evitimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit dhe përbërësve të tij si dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve për Qarkun Tiranë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi financiar rezulton se hyrjet dhe daljet e disa mallrave e materialeve të magazinës nuk janë bërë sipas Regjistrit të aktiveve të njësisë të sektorit publik.

- Në asnjë rast nuk ka urdhër për daljen e materialeve nga magazina. Nuk ka të hapur librin e magazinës dhe kartelat e magazinës; veprime këto në kundërshtim me kapitullin e III-te, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre,” të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” pika 27,38 dhe 40 (*Trajtuar në faqet 105-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. Rekomandimi: Sektori i Financës të DRM Qarkut Tiranë, pavarësisht nga madhësia e vlerave materiale që disponon, të krijojë rregullshmërinë ligjore të kryerjes së veprimeve dhe të marrë të gjitha masa për dokumentimin e hyrjeve dhe daljeve të mallrave e materialeve të magazinës duke çelur e mbajtur Regjistrin e aktiveve të njësisë të sektorit publik, si dhe të hapet libri i magazinës me kartelat përkatëse ku të evidentojë çdo dalje të materialeve të shoqëruar me urdhrin përkatës të titullarit apo personit të autorizuar..

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

3. Gjetje nga auditimi: DRM-në Qarku Tiranë, për vitet 2014 dhe 2015, nuk ka ndjekur hapat ligjor për instalimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, pasi nuk ka hartuar program për ngritjen e sistemit të MFK për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

- Nuk është ngritur struktura për të përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale të punonjësve kryesorë bazuar në qëllimet strategjike dhe prioritetet e institucionit të DRM-së, si përcaktohet në nenet nr. 9, 10,11 dhe 12 të ligjit dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010, “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Nuk është hartuar program, nuk është organizuar sistemi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm (SMKB), si dhe nuk janë përcaktuar procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në këtë njësi publike.

- Nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik, në zbatim të nenin 27/2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe nuk dokumentohen dhe evidentohen masa për rritjen e nivelit të kualifikimit të nevojshëm të punonjësve si trajnime pranë institucioneve përkatës të Ministrisë të Financës.

- Në asnjë rast nga institucionet përkatës të Ministrisë të Financës, nuk ka ardhur asnjë shkresë, “Për caktimin e nëpunësve autorizues në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, në zbatim të Urdhrit nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, Udhëzimi nr. 28 datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit

vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm” të MF (Trajtuar në faqet 60-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Rekomandim: Nga DRM Qarku Tiranë të hartohet program për ngritjen e sistemit të MFK, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Të ngrihen strukturat për të përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale të punonjësve kryesorë, me synim realizimin e qëllimit, misionit, vizionit, objektivave strategjike dhe prioritetet e institucionit të DRM-së, dhe të përcaktohen procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në këtë njësi publike.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: DRM Tiranë, nuk ka një Rregullore të Brendshme të hartuar dhe miratuar në zbatim të VKM nr. 47 datë 29.01.2014, si Entitet pas ndarjes së këtij institucioni nga AKM, i cili përcakton se veprimtaria e DRM duhet të organizohet mbi bazën e të drejtave që i jep ligji. Në këtë institucion nuk janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet që ngarkon ligji për plotësimin e misionit të tyre. Veprimtaria e miratimit apo refuzimit nga kjo strukturë të lejeve të mjedisit të tipit C bëhet formale dhe pa u shprehur për përmbajtjen profesionale të aktivitetit (Trajtuar në faqet 103-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Rekomandimi: Titullari i DRM Tiranë mbi bazën e VKM së krijimit dhe dispozitave ligjore të hartojë Rregulloren dhe t’i kërkojë AKM –së , si organ nga i cili varet, miratimin e Rregullores së Brendshme, e cila aktualisht është vetëm një draft Rregullore.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Njësia e Prokurimit në planifikimin e fondeve për prokurime nuk ka përllogaritje të fondit limit në asnjë rast. Fondi i prokuruar i referohet buxhetit të miratuar të institucionit dhe në disa raste testimi i tregut është bërë mbasi është përcaktuar fondi limit për objektin që do të prokurohet, duke mos bërë përllogaritjen e tij në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, kreu II, pika 2, germa ç, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu II, neni 9, pika 1 (Trajtuar në faqet 115-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Rekomandimi: Nga Titullari i institucionit dhe Njësia e Prokurimit në prokurimet për blerje me vlera të vogla, të marren masa për përllogaritjen e saktë të fondit limit, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

6. Gjetje nga auditimi: DRM Tiranë, nuk ka marrëveshje të përbashkëta me organet e tjera të kontrollit, nuk janë hartuar programe kontrolli, plane pune dhe nuk janë kryer inspektime të përbashkëta, mosveprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu II “Parimet e mbrojtjes së Mjedisit”, neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit” (Trajtuar në faqet 70-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Rekomandimi: Nga titullari i institucionit të merren masa për kryerjen e inspektimeve e kontrolleve të përbashkëta, duke hartuar plane pune, programe të përbashkëta me organet e tjera të kontrollit, në përputhje me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu II “Parimet e mbrojtjes së Mjedisit”, neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit”, pika 1.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të aplikimit të shqyrtuara nga DRM Tiranë për periudhën 2014 konstatohet se, në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C rezultojnë mangësi si: adresimi i shqyrtimit të lejes specialistëve të

DRM, mbajtja e procesverbaleve të komisionit të shqyrtimit, përshkrimin e instalimeve të domosdoshëm për ushtrimin e aktivitetit, nuk janë bashkëngjitur planet, skicat, hartat për ta përshkruar të gjithë aspektin e aktivitetit, mungojnë deklaratimet nga subjektet në lidhje me mbetjet e ngurta (Ilumrat e depozitave) që gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë, mungesa e koordinatave GAUS KRUGE, mungesa e dokumentit të pronësisë së tokës, mos deklarimi i informacioni në tabelat për shkarkimet e ujërave të ndotura, mbetjet e ngurta, përdorimi dhe prodhimi i energjisë, zhurmat dhe vibracionet sipas (tipit sasisë dhe burimit), mos plotësimi në mënyrë korrekte të kodit kryesor të aktivitetit, mungesa dhe veprime që janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, Vendimin nr.419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja" (*Trajtuar në faqet 103-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7. Rekomandimi: DRM Qarku Tiranë të marrë të gjitha masat për shqyrtimin në mënyrë objektive dhe korrekte të të gjitha kërkesave të subjekteve që kërkojnë të pajisen me Leje Mjedisit Tipi C, të plotësojnë formularin informues sipas kërkesave ligjore që janë në fuqi dhe të plotësojnë dosjen e aplikimit në rrugë elektronike dhe manuale me të gjithë dokumentacionin përkatës dhe mbështetës në lidhje me aktivitetin që do të ushtrojnë dhe lejen përkatëse që pajisen.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për vitin 2014 konstatohet se në dokumentacionin e subjekteve që iu është dhënë Akt Miratimi për Leje Tipi C, rezultojnë të njëjtat mangësi me ato që janë refuzuar, duke bërë që për vendimet e marra në lidhje me shqyrtimin e dosjeve të përdoren standarde të dyfishta për plotësimin e dokumentacioneve, veprime këto në kundërshtim me kërkesat ligjore referuar Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B Dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja" (*Trajtuar në faqet 99-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8. Rekomandimi: DRM Qarku Tiranë, në shqyrtimin e Lejeve të Mjedisit të Tipit C të përdorë kushte dhe kërkesa të njëjta për plotësimin e informacionit të deklaruar nga ana e subjektit që aplikon për Leje Tipi C, të vendosë rregulla për dokumentacionin shtesë që subjektet duhet të kenë në dosjen e aplikimit gjë që të cilat do të vërtetojnë saktësinë e të dhënave që plotësohen në formularin informues pa bërë dallime dhe diferencime për plotësimin sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet për vitin 2014, se nga subjektet që marrin leje mjedisore kanë detyrim ligjor për hartimin e raporteve të vetë monitorimeve dhe kanë detyrim ligjor për të sjellë një herë në gjashtë muaj të dhënat e monitorimit mjedisor, pranë DRM Tiranë . Ky informacion periodik mjedisor nuk është paraqitur, duke vepruar kështu në kundërshtim me kushtet e vendosura në Lejen e Mjedisit apo të Autorizimit Mjedisor dhe Vendimit nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja" (*Trajtuar në faqet 101-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9. Rekomandimi: DRM Tiranë dhe Specialisti i Monitorimeve të marrin masat e duhura për të njoftuar subjektet në lidhje me vetë monitorimet e përcaktuara në kushtet e Lejes Mjedisore si dhe të rrisin bashkëpunimin institucional për koordinimin dhe për realizimin e detyrave për të cilët këto institucione janë përgjegjës, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga DRM Tiranë, për vitin 2014, regjistri i refuzimeve nuk është mbajtur me standardin e aprovuar nga Ministria e Mjedisit. Regjistri është mbajtur në rrugë elektronike. Në të dhënat e regjistrit janë krijuar formate të ndryshme ku ka raste si muaji Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor nuk janë plotësuar kolonat me emrin e specialistëve, në raste të tjera nuk është shënuar në se aplikimi është refuzuar ose jo. Aktet e refuzimit nuk kanë bashkëlidhur relacionin apo dokumente të tjera vërtetuese për arsyet e refuzimit të aplikimit. Për këto veprime nga ana e Drejtorisë ka munguar përcaktimi i rregullave dhe kriterëve të shqyrtimit të dosjeve nga specialistët. Në aktet e refuzimit nuk ka argumentim nga specialistët, por është shënuar vetëm fjala “konceptoi”. Për aktet e refuzuara nga Drejtoria nuk është zbatuar VKM Nr. 419, datë 25.06.2014, kreu IV pika 7 “Akti i miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit C i dërgohet AKM“ sipas shtojcës 6 bashkëlidhur vendimit (*Trajtuar në faqet 100-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10. Rekomandimi: DRM Tiranë të marrin masat e duhura për të krijuar e plotësuar formatet uniform për gjithë periudhën e vitit dhe nga të gjithë specialistët, duke plotësuar të gjitha kolonat e formatit me emrin e subjektit, datën e aplikimit, datën e shqyrtimit, emrin e specialistit që trajton dosjen, duke shënuar në se aplikimi është refuzuar ose jo

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në të 230 dosjet e audituara, për vitin 2015, kërkesat (aplikimet) e operatorëve për leje të tipit “C” dhe mendimet për VNM për lejet e tipit “A” dhe “B”, vijnë në rrugë elektronike nga QKL-ja(Qendra Kombëtare e Licencimeve). Nuk është nxjerrë ndonjë akt ligjor apo nënligjor për regjistrimin elektronik në rastin e përcjelljes së kërkesave në ARM Qarku Tiranë dhe përveç kësaj, këto kërkesa vijnë nga QKL, në një kohë që sipas VKM nr. 419, datë 25.06.2014, duhet të përcillen nga AKM në ARM Qarku Tiranë.

Kalimi nëpërmjet rrugës elektronike, nuk garanton siguri për të dhënat e përcjella nga QKL, të cilat na u paraqitën në një folder të kopjuar, gjë që nuk jep siguri për saktësinë dhe vlefshmërinë e të dhënave dhe nuk siguron një shprehje të padyshimtë të vullnetit nga ana e përcjellësit të këtyre të dhënave përmes kësaj rruge elektronike.

Kërkesat e aplikuesve për leje mjedisore të tipit “C” janë përcjellë nga QKL-ja, nëpërmjet **rrugës elektronike (dixhitale)** dhe jo në formë shkresore, në kundërshtim me pikën “2” të Kreut IV të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 dhe me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Titulli III (*Trajtuar më hollësisht në faqet 84-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranë, të mos pranojë më kërkesa nga operatorë, për leje mjedisore të tipit “C” të cilët vijnë në mënyrë elektronike nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), por të pranojë vetëm ato kërkesa për leje mjedisore të tipit “C”, të cilat u përcillen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

Kërkesat e operatorëve për leje mjedisore, të pranohen nga DRM në mënyrën elektronike të bashkëshoqëruar në çdo rast nga dokumentacionet përkatës në trajtën fizike, të nënshkruara e vulosura rregullisht, si dokumentacion që përmban elementet e formës dhe të përmbajtjes për të qenë një akt administrativ i rregullt dhe ligjor.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

12. Gjetje nga auditimi: Në të **230 dosjet** e audituara, për vitin 2015, aktet e miratimit dhe proces-verbalet e komisioneve janë hartuar me pasaktësi pasi: nuk ka të dhëna të detajuara dhe të hollësishme për shkarkimet në mjedis, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, “Lista indikative e substancave kryesore ndotëse” që duhen marrë parasysh nëq kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve”, si pjesë e kushteve për dhënien e lejes së mjedisit tipi “c”, e përcaktuar si kërkesë bazuar në VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10, dhe në VKM nr. 435, datë 12.9.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”, ku akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit “C”, për çdo instalim, përmban sipas rastit, vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi. Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo për ndotës të veçantë”(Trajtuar më hollësisht në faqet 100-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranë, (Drejtori dhe komisionet), të hartojnë hollësisht dhe në mënyrë të detajuar proces-verbalet dhe aktet e miratimit të kërkesave për leje mjedisi tipi “C”, mbi bazën e të dhënave të detajuara për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve, për komponentët mjedisorë “Ajri” dhe “Uji”, ku për komponentin “**Ajri**” kërkohet respektimi i vlerave kufi për agjentët atmosferikë si: dyoksidi i squfurit dhe komponime të tjera sulfurorë, oksidet e azotit dhe komponime të tjera azoti, monoksid karboni, përbërës organikë të avullueshëm, metalet dhe përbërës të tyre, pluhuri, azbesti (grimca pezull, fibra), klori dhe përbërësit e tij, flori dhe përbërësit e tij, arseniku dhe përbërësit e tij, cianide, substanca dhe preparate që janë provuar të kenë veti *kancerogjene ose mutagjene*, apo veti që mund të cenojnë riprodhimin nëpërmjet ajrit, dibenzodioksinë e poliklorinuar dhe dibenzofuran i poliklorinuar. Për komponentin “Uji” të kërkohet respektimi i vlerave kufi për agjentë atmosferikë si: komponimet dhe substancat organo-halogjene që mund të formojnë komponime të tilla në mjedisin ujor, komponime organo-fosforike, komponime organotin, substanca dhe preparate që janë provuar të kenë veti kancerogjene ose mutagjene që mund të cenojnë riprodhimin në mjedisin ujor ose nëpërmjet tij, hidrokarburet e qëndrueshme dhe substancat e qëndrueshme dhe toksike organike të bioakumulueshme, cianide, metalet dhe komponimet e tyre, arseniku dhe komponimet e tij, biocidet dhe produktet për shëndetin e bimëve, materialet që rrinë pezull, substancat që kontribuojnë në eutrofikim (veçanërisht nitratet dhe fosfatet), substancat që kanë ndikim të pafavorshëm në balancën e oksigjenit (dhe që mund të maten duke përdorur parametra si BOD, COD etj.). DRM të japë një konfirmim negativ, në rast se këta komponentë dhe shkarkime ndotësish në ajër dhe ujë, nuk janë konsideruar në caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

13. Në 21 raste, për vitin 2015, aktet i miratimit janë hartuar lidhur më kushtin “7” të formatit të këtij akti “Zhurmat”, mbi bazën e verifikimeve përkatëse dhe konkluzioneve përfundimtare, sipas ekspertizës së kryer nga ISHP-ja.

Në konkluzionet përfundimtare rezulton që ekspertiza është kryer duke matur nivelin e zhurmave në brendësi të lokaleve dhe në fonet e rrugëve, konkluzione të cilat nuk kanë marrë parasysh nivelet kufi të zhurmave të ndara sipas orëve të ditës, por kanë quajtur të pranueshme vetëm një nivel, për të gjithë ditën, nivel ky që është gjithmonë më i lartë se **30-45 dB(A)**, i cili është kufiri maksimal i pranimit të zhurmës për kohën e orëve të natës prej orës 23⁰⁰ – 6⁰⁰, veprime këto në kundërshtim me:

- Ligjin nr. Nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 10, “Oraret”;

-Udhëzimin MMPAU dhe MSH Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”, aneksi 1, “Mbi kufijtë e zhurmave, sipas orëve të ditës”;

-Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë”, pikat 5,6,7,8,9,10,11 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranë, të marrë masa dhe të mos lëshojë leje mjedisore tipi “C”, për lokalet e natës, nëse në konkluzionet përfundimtare të nxjerra nga ekspertiza e ISHP, duke kryer dhe duke matur nivelin e zhurmave në brendësi të lokaleve dhe në fonet e rrugëve, nuk janë marrë parasysh nivelet kufi të zhurmave të ndara sipas orëve të ditës, por kanë quajtur të pranueshme vetëm një nivel për të gjithë ditën, ku niveli **30-45 dB(A) të jetë kufiri maksimal i pranimit të zhurmës për kohën e orëve të natës: prej orës 23⁰⁰ – 6⁰⁰**

Menjëherë dhe Vazhdimisht

14. Gjetje nga auditimi: Në **65 dosje**, për vitin 2015, lidhur me gjenerimin e zhurmave në mjedis për aktivitetet e tjera, në zona të banuara, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë”, shtojca I, konstatohet se përveç rastit të lokaleve të natës, veprimtaritë e specializuara të argëtimit që gjenden në zonat e banuara, në asnjë rast tjetër nuk është proceduar nga ana e ISHP me hartimin e raporteve për nivelet e pritshme të zhurmës që do të çlirohen në mjedis nga veprimtaritë e tjera të cilat gjenerojnë zhurma në mjedis. Në proces-verbalet e komisioneve dhe aktet e miratimit, të cilët janë hartuar formalë, nuk është reflektuar mbi nivelin e zhurmave që gjenerohen nga këto 62 subjekte, mosveprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 10;

-Udhëzimin MMPAU dhe MSH Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”, aneksi 1, “mbi kufijtë e zhurmave, sipas orëve të ditës;

-Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë”, pikat 5,6,7,8,9,10,11 dhe shtojca I (*Trajtuar në faqet 95-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranë, të marrë masa dhe të kërkojë hartimin e akt-ekspertizës nga ISHP, përveç rasteve të lokaleve të natës e veprimtaritë e specializuara të argëtimit që gjenden në zonat e banuara, edhe për të gjithë veprimtaritë e tjera që gjenerojnë zhurmë, si më poshtë:

1. Furra të prodhimit të bukës
2. Serviset e automjeteve, gomisteritë, dhe pikat e larjes së automjeteve
3. Punishtet/veprimtaritë e saldimit të metaleve
4. Veprimtaritë e prodhimit/përpunimit të duraluminit
5. Veprimtaritë e përpunimit të mermerit dhe gurëve dekorativë
6. Veprimtaritë e prodhimit të mobilieve
7. Veprimtaritë që për shkak të natyrës së tyre përdorin vazhdimisht gjenerator/Ventilues
8. Nyjat e fraksionimit të mineraleve
9. Prodhimi i betonit, llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, blloqeve, etj.)
10. Punishtet e pijeve alkoolike, produkteve shtazore dhe bimore.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

15. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet, për vitin 2015, konstatohet se në DRM, Qarku Tiranë, për shkarkimet e ngurta nuk aplikohen norma sipas lejeve mjedisore të lëshuara deri tani, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10 dhe me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”(Trajtuar më hollësisht në faqet 101-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranë, të marrë masa dhe të aplikojë norma për shkarkimet e ngurta sipas lejeve mjedisore të lëshuara ndaj subjekteve.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

16. Në 17 raste, për vitin 2015, mungojnë kërkesat në formë dixhitale që duhej të ishin dorëzuar nga aplikuesit/ kërkuessit, mosveprim në kundërshtim me pikat 2,3,4,5, *Kreu IV, i VKM nr. 419, datë 25.06.2014 (Trajtuar më hollësisht në faqet 99-115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranë, të marrë masa dhe t'i kërkojë Inspektoratit të Mjedisit dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, pezullimin e lejeve të mjedisit të tipit "C", për 17 rastet e konstatuara me mungesë të kërkesave në formë dixhitale që duhej të ishin dorëzuar nga aplikuesit/ kërkuessit, si më poshtë:

1. K. T., akt-miratimi 21, datë 13.01.2015 "Menaxhim mbetje"
2. B.C., akt-miratimi 135, datë 02.04.2015 "Ambulancat, spitalet ditore pa shtretër, poliklinikat dentare me mbi 3 poltrona, laboratorët mjekësorë dhe dentarë"
3. E. A., akt-miratimi 137, datë 08.04.2015, "Gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme"
4. V. Gj., akt-miratimi 138, datë 02.04.2015, Magazinim, ngarkim ose shkarkim në masë të madhe të çimentos, përpara transportit të saj në masë të madhe"
5. E.e, 140, datë 02.04.2015, "Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave"
6. R.B. akt-miratimi 139, datë 02.04.2015, "Riparim dhe mirëmbajtje pajisjeve motorike dhe motoçikletave"
7. A.I, akt-miratimi: 136, datë 02.04.2015, "Riparim dhe mirëmbajtje pajisjeve motorike dhe motoçikletave"
8. F.A, akt-miratimi: 154, datë 09.04.2015, Furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant. Furnizim për mbushje gazi GLN
9. Ç.A, akt-miratimi: 152, datë 09.04.2015, "Magazinimi i kimikateve"
10. A.RR., akt-miratimi: 150, datë 09.04.2015, "Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve. Pastrim kimik"
11. E.R, akt-miratimi 153, datë 09.04.2015 "Ambulancat, spitalet ditore pa shtretër, poliklinikat dentare me mbi 3 poltrona, laboratorë mjekësorë dhe dentarë"
12. A.B., akt-miratimi 151, datë 09.04.2015 "Ambulancat, spitalet ditore pa shtretër, poliklinikat dentare me mbi 3 poltrona, laboratorë mjekësorë dhe dentarë"
13. I.K, akt-miratimi: 191, datë 08.05.2015, "Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme"
14. A.N., akt-miratimi 210, datë 18.05.2015, "Poliklinikë dentare me mbi 3 poltrona, laboratorë mjekësor dhe dentar"
15. R.A 63, akt-miratimi 214, datë 25.05.2015, "Gatimi dhe tregtimi i produkteve të gatshme dhe gjysmë të gatshme"
16. E.Xh, akt-miratimi 323, datë 24.08.2015, "Veprimtari që përfshijnë përdorimin e solventëve. Pastrim Kimik"
17. R.c 2014, akt-miratimi 362, datë 28.09.2015, "Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave".

Të rishikohen dhe të saktësohen nëse të gjitha lejet janë dhënë sipas procedurave ligjore dhe të marrë vendimet përkatëse sipas ligjit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet, në dosjet e audituara gjatë vitit 2015, konstatohet se nga DRM Qarku Tiranë është dhënë mendim për leje të tipave "A" dhe "B" dhe për VNM, në një kohë që për të gjitha rastet, në dosjet disponibël dhe në sistemin elektronik, nuk ndodhen

mendimet me argumentet përkatëse në favor të mendimeve pozitive që janë dhënë për lejet mësipërme (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarku Tiranë, të hartojë hollësisht dhe në mënyrë të detajuar proces-verbalet, ku të trajtohen me imtësi arsyet dhe argumentet përkatëse në favor të mendimeve pozitive për lejet e tipeve “A” dhe “B” apo arsyet e mospranimeve (negative) të këtyre lejeve.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

18. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet për vitin 2015, në dosjet e refuzuara për dhënie leje mjedisore të tipit “C”, mungojnë akt-refuzimet dhe informacionet përkatëse shpjeguese, dosjet e refuzuara janë të panëshkruara nga komisionet, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, Kreu IV “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit “C”, pika 5 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarku Tiranë, të hartojë hollësisht dhe në mënyrë të detajuar proces-verbalet, ku të trajtohen me imtësi arsyet e refuzimit duke nënshkruar në çdo rast dokumentacionin përkatës. Të aplikohet hartimi i akt-refuzimeve, për të gjitha rastet.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

19. Gjetje nga auditimi: Nga informacioni i ardhur nga ISHM në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, në vitin 2014 dhe vitin 2015 janë gjobitur 257 subjekte në vlerën totale **25,947,000 lekë**, nga të cilat 99 subjekte të gjobitur në **vlerën 14,737,099 lekë**, nuk kanë adresa të sakta, NIPT përkatës të subjektit, emrin e administratorit, në kundërshtim me nenin 39 dhe 40 të ligjit nr 9920, datë 15.05.2008 “Procedurat Tatimore” dhe në kundërshtim me nenin 23 “Menaxhimi i Informacionit pika 2 si dhe neni 27 të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 84-102, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit, Qarku Tiranë, për subjektet e gjobitura nga ISHM, për të cilat konstatohet se nuk janë të dhënat e plota, t’i kërkojë në rrugë shkresore ISHM-së, të dhënat e plota me të gjitha modalitetet që përmban procesverbali, si numrin e vendimit të gjobës, subjekti, numrin e serisë së mandatit të gjobës, data, shuma, adresa, arsyeja e gjobës, nëse kanë shlyer gjobën dhe të marrë masa, duke krijuar një “database” të veçantë, i cili të përdoret në rastin e revokimit të lejeve mjedisore.

Deri më datë 31.12.2016

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi kryer në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, u konstatua se nuk është hartuar plani i të ardhurave nga aplikimi dhe miratimi i lejeve mjedisore të tipit C në fillim të vitit kalendarik, veprime këto që bien në kundërshtim me ligjin e buxhetit të shtetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 23 pika ç (*Trajtuar më hollësisht në faqet 23-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, të marrë masat që në fillim të çdo vitit kalendarik të bëjë parashikimin e të ardhurave, në bazë të ardhurave të vitit paraardhës si dhe sipas Ligjit të Buxhetit të Shtetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 23 pika ç.

Vazhdimisht

21. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, nuk ka një korrespondencë të saktë të akordimit të ardhurave me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si dhe nuk është mbajtur një regjistër nga specialisti i financës për rakordimin në çdo fund muaji për vitin 2014-2015, për numrin e subjekteve të cilat nuk kanë kryer pagesat, për të cilat e kanë detyrim ligjor arkëtimin e tyre (*Trajtuar më hollësisht në faqet 76-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të marrë masat që të hartojë dhe të përditësojë një database, me të dhënat e subjekteve për arkëtimin e tarifave dhe kuadrumin në fund të çdo muaji, për nxjerrjen e evidencave për subjektet debitore në fund të vitit kalendarik.

Vazhdimisht

22. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, nuk është bërë asnjë shkresë për të informuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesat e tarifave të përcaktuara në ligjin dhe në vendimet e sipërcituara ndaj të cilave duhet të merreshin masat administrative sipas Ligjit nr. 10488 datë 27. 04.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 25-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, të marrë të gjitha masat që të informojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit në tremujorin e parë të vitit pasardhës, për subjekte të cilat nuk kanë paguar tarifën vjetore sipas ligjit të sipërcituar.

Vazhdimisht

23. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit në dy vitet periudhë auditimi nuk është informuar me shkresë përcjellëse QKL-së sipas ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, neni 25, Tarifat për lejet e mjedisit të tipit C. pika 6. Agjencia përkatëse Rajonale e Mjedisit i kërkon QKL-së revokimin e lejes së mjedisit të tipit C, për revokimin e lejeve të këtyre subjekteve të cilat nuk kanë kryer tarifën vjetore, si dhe kanë kaluar të gjitha afatet për kryerjen e pagesave (*Trajtuar më hollësisht në faqet 80-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, të marrë masat që të informojë me anë të shkresave përcjellëse në çdo rast QKL-në, në mënyrë që të merren masat për revokim të lejeve për subjekteve që nuk kanë paguar tarifën vjetore në kundërshtim me ligjin e sipërcituar.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

24. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, për periudhën objekt auditimi nuk ka një database për autorizimet dhe pëlqimet mjedisore të tipit A,B dhe C, sipas udhëzimit nr. 5 datë 28.12.2007 “Për tarifën e shërbimit”, që nga vit 2009-2013, nëse këto subjekte vazhdojnë aktivitetin e tyre, kanë penalitete të papaguara, apo janë pjesë e subjekteve të pajisura me leje për vitet 2014-2015 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 75-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, të marrë masat që të nxjerrë të gjitha të dhënat për subjektet e pajisura me pëlqime mjedisore, për periudhën 2009-2013, për të parë nëse këto subjekte kanë penalitete të papaguara, apo vazhdojnë aktivitetin e tyre.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, u konstatua se nuk ka një numër llogarie bankare ku operatorët ekonomikë të kryejnë pagesat e tyre, në kundërshtim me vendimin nr. 419 datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Tarifave të Lejeve Mjedisore”, pika 5 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 23-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

25. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, të marrë masat për hapjen e numrit të llogarisë, sipas vendimit të sipërcituar, në mënyrë që subjektet të derdhin detyrimet e tyre brenda afateve kohore.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, nuk ka mbajtur sigurimet shtetërore suplementare të punonjësve, në kundërshtim me ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për

pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 9990 date 15.09.2008, neni 1 pika 9, si dhe referuar kërkesave të Vendimit nr 499, date 21.09.2000 pika 3 dhe 4 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 25-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

26. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit të kërkojë zyrtarisht AKM-së, që në mbështetje të akteve ligjore në fuqi cituar sa më sipër, të ndërmarrë hapat përkatëse për përfshirjen e punonjësve të institucionit në listën e punonjësve me detyrimin konformë ligjit, të pagesave të sigurimeve suplementare.

Deri më datë 31.12.2016

27. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, nuk ka marrë masa për zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i KLSH, nuk ka asnjë program të detajuar dhe përcaktuar me afatet kohore, ndarjen e detyrave, personat përgjegjës si dhe ndjekjen e tyre. Sipas shkresës me nr. 835/2 prot. datë 04.07.2014 është kthyer përgjigje institucionit të KLSH dhe nuk ka dërguar informacion tjetër sipas afateve ligjore sipas nenit 15 germa "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për masat e marra sipas programeve të përgatitura për zbatimin e rekomandimeve, të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit *brenda 20 ditëve* nga marrja e kësaj kërkesë, si dhe në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit *brenda 6 muajve* (*Trajtuar më hollësisht në faqet 6-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

27. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit të planifikoje dhe të caktojë grup pune mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm dërguar me shkresën me nr. 835/2 prot. datë 04.07.2014 dhe të informojë zbatimin e tyre në KLSH sipas ligjit.

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, nuk ka bashkëpunuar dhe nuk ka marrë informacion në kohe nga ISHM për 10 subjekte e gjobitura në vlerë **3,020,000 lekë**, të cilat janë pajisur me licencë të Tipit C, në kundërshtim me nenin 23 "Menaxhimi i Informacionit pika 2 si dhe nenin 27 të Ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e mjedisit", si e ardhur e munguar në Buxhetin e Shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 6-21, pasqyra 1/1 e Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

28. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit në bashkëpunim me ISHM, të marrë masa për pezullimin e lejeve mjedisore të subjekteve debitoare, deri në shlyerjen dhe arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të vlerës prej 3,020,000 lekë gjoba të vendosura dhe të pa likuiduara nga këto subjekte, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, **në vlerën totale 2,066,000 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Tiranë u konstatua se për periudhën e audituar janë të pajisura me leje mjedisore të tipit C, 1334 subjekte nga të cilat

vetëm 301 subjekte kanë derdhur tarifën vjetore dhe 1033 subjekte nuk kanë derdhur tarifën vjetore në vlerën totale **2,066,000 lekë** (1033 subjekte x 2000 lekë), në kundërshtim me ligjin nr.10488 datë 27.04.2011 “Për Lejet Mjedisore”(Trajtuar më hollësisht në faqet 23-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë në bashkëpunim me ISHM, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **2,066,000 lekë** (1033 subjekte x 2000 lekë), ndaj subjekteve debitorë, të cilët kanë kaluar të gjitha afatet ligjore dhe nuk kanë derdhur tarifën vjetore pranë DRM.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a”, “b” e “ç” e nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rekomandojmë Ministrin të Mjedisit fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:**

C/1. “Largim nga shërbimi civil” për:

1. S.P, me detyrë ish Drejtor i DRM Tiranë për periudhën e vitit 2014 – 2015, aktualisht punonjëse në Ministrinë e Mjedisit, pasi nga auditimi janë konstatuar shkelje e mangësi si më poshtë:

- Nuk është ngritur struktura për të përcaktuar përgjegjshmërinë menaxheriale të punonjësve kryesorë bazuar në qëllimet strategjike dhe prioritetet e institucionit të DRM-së, si përcaktohet në nenet nr. 9, 10,11 dhe 12 të ligjit dhe UMF nr. 54, datë 15.7.2010, “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Të meta e mangësi në organizimin e punës dhe përcaktimin e detyrave të punonjësve për mos mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik sipas kërkesave të shtojcës 4 të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 me të dhëna për instalimet e kategorisë C, që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre.

-Mos mbajtje e procesverbaleve të mbledhjeve të komisioneve të shqyrtimit, në marrjen e vendimeve për dhënien e lejeve të mjedisit të tipit C.

-Për të meta e mangësi në dhënien e lejeve të tipit C për 60 raste të pikave të karburantit. Konkretisht, nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr. 419, datë 25.06.2014, Kreu IV, pika 10, Akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit C për çdo instalim nuk përban dhe nuk ka të përshkruar sipas rastit :

a) Vlerat Kufi të shkarkimit të ndotësve në mënyrë të veçantë atë to listuara në shtojcën 2 të ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011

- Nuk ka marre informacion rregullisht njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe njësinë e Inspektoriatit Shtetëror për Mjedisin mbi të dhënat e vetmonitorimit.

-Në aplikime mungojnë vërtetimi nga Inspektoriatit Qëndror Teknik referuar ligjit "Për Emergjencat Civile.

-Për mos zbatim të pikës 1 të Urdhrit të Brendshëm të Ministrin të Mjedisit nr. 37, datë 29.03.2004 “ Për realizimin e vetmonitorimit “ ku kërkohet që subjektet e pajisura me Leje Mjedisore ose Autorizim Mjedisor duhet të hartojnë “Program Vetëmonitorimi të veprimtarisë së

tyre dhe një kopje i dërgojnë pranë DRM. Në vitin 2014 nuk evidentohet asnjë raport vetmonitorimi.

- Për të meta e mangësi në shqyrtimin dhe refuzimin e 54 aplikimeve për leje mjedisi të tipit C e konkretisht:

-Rregjistri i refuzimeve nuk është mbajtur me standardin e aprovuar nga Ministria e Mjedisit. Për vitin 2014 është mbajtur regjistri në rrugë elektronike. Në të dhënat e regjistrin janë krijuar formate të ndryshme ku ka raste si muaji shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor që nuk janë plotësuar kolona me emrin e specialistit, në raste të tjera nuk është shënuar në se aplikimi është refuzuar ose jo.

-Aktet e refuzimit të firmosura nga S.P, nuk kanë bashkëlidhur relacionin apo dokumente të tjera vërtetuese për arsyet e refuzimit të aplikimit. Për këto veprime nga ana e Drejtorisë ka munguar përcaktimi i rregullave dhe kriterëve të shqyrtimit të dosjeve nga specialistët. Në aktet e refuzimit të firmosura nga ish Drejtori për kryerjen e detyrës nga specialistet është shënuar vetëm fjala “konceptoi” dhe pa emër.

-Për aktet e refuzuara nga Drejtoria nuk është zbatuar VKM 419, datë 25.06.2014, kreu IV pika 7 “Akti i miratimit/refuzimit të lejes së mjedisit të tipit C për dërgimin AKM “ sipas shtojcës 6 bashkëlidhur vendimit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Kreu III, dispozita përfundimtare pika 2 e VKM nr. 419, datë 25.06.2014, ARM (DRM), mban administron dhe përditëson regjistrin e lejeve të mjedisit të tipit C.

-Për vitin 2014 nuk ka dërgim informacioni në ISHM.

-Nuk janë hartuar programe kontrolli e bashkëpunimi me plane pune dhe nuk janë kryer inspektive të përbashkëta, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, kreu II “Parimet e mbrojtjes së Mjedisit”, neni 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit”

-Për mos zbatim të pikës 1 të Urdhrit të Brendshëm të Ministrit të Mjedisit nr. 37, datë 29.03.2004 “ Për realizimin e vetmonitorimit “ ku kërkohet që subjektet e pajisura me Leje Mjedisore ose Autorizim Mjedisor duhet të hartojnë “Program Vetëmonitorimi të veprimtarisë së tyre dhe një kopje i dërgojnë pranë DRM. Kjo detyrë për vitin 2014, sipas shkresës nr. 713 prot, datë 27.05.2014 mbulohej nga specialistja e monitorimit.

-Për të meta e mangësi në dhënien e lejeve të tipit C për 60 raste të pikave të karburantit. Konkretisht nuk janë zbatuar kërkesat e Vendimit të mësipërm, Kreu IV, pika 10, Akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit C për çdo instalim nuk përban dhe nuk ka të përshkruar sipas rastit :

- Në 230 dosje të audituara për vitin 2015, konstatohet se kërkesat (aplikimet) e operatorëve për leje të tipit “C” dhe mendimet për VNM për lejet e tipeve “A” dhe “B”, vijnë në rrugë elektronike nga QKL-ja. Nuk është nxjerrë ndonjë akt ligjor apo nënligjor për regjistrimin elektronik në rastin e përcjelljes së kërkesave në DRM Qarku Tiranë dhe përveç kësaj, këto kërkesa (aplikime) vijnë nga QKL (Qendra Kombëtarë e Licencimeve) në një kohë që sipas VKM 419, datë 25.06.2014, duhet të përcillen nga AKM (Agjencia Kombëtarë e Mjedisit) në ARM Qarku Tiranë.

Kalimi nëpërmjet rrugës elektronike, nuk garanton siguri për të dhënat e përcjella nga QKL, të cilat na u paraqitën në një folder të kopjuar, gjë që nuk jep siguri për saktësinë dhe vlefshmërinë e të dhënave dhe nuk siguron një shprehje të padyshimtë të vullnetit nga ana e përcjellësit të këtyre të dhënave përmes kësaj rruge elektronike.

Kërkesat e aplikuesve (kërkuesve) për leje mjedisore të tipit “C” janë përcjellë nga QKL-ja, nëpërmjet *rrugës elektronike (dixhitale)*, dhe jo në formë shkresore, në kundërshtim me pikën “2”, të Kreut IV, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 dhe me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Titulli III (*Trajtuar më hollësisht në faqet 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **230 dosje të** audituara për vitin 2015, konstatohet se aktet e miratimit dhe proces-verbalet e komisioneve janë hartuar formalë; nuk ka të dhëna të detajuara dhe të hollësishtme për shkarkimet në mjedis, sipas shtojcës 2, tabela: “Lista indikative e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh nëq kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve”, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, si pjesë e kushteve për dhënien e lejes së mjedisit tipi “C”, e përcaktuar si kërkesë bazuar në VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10 dhe në VKM nr. 435, datë 12.9.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.

Sa më sipër, akti i miratimit për lejen e mjedisit të tipit “C”, për çdo instalim, duhet të përmbajë sipas rastit, *vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi*. Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo për ndotës të veçantë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 100-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **21 raste**, për vitin 2015, aktet e miratimit janë hartuar lidhur me kushtin “7”, të formatit të këtij akti, për komponentin mjedisor: “Zhurmat”, mbi bazën e verifikimeve përkatëse dhe konkluzioneve përfundimtare, sipas ekspertizës së kryer nga ISHP-ja (Instituti i Shëndetit Publik).

Në konkluzionet përfundimtare rezulton që ekspertiza është kryer duke matur nivelin e zhurmave në brendësi të lokaleve të natës dhe jashtë tyre në fonet e rrugëve, konkluzione të cilat nuk kanë marrë parasysh nivelet kufi të zhurmave të ndara sipas orëve të ditës, por kanë quajtur të pranueshme dhe të mirëqenë vetëm një nivel zhurme për të gjithë ditën, nivel ky që është gjithmonë më i lartë se 30-45 dB(A), i cili është kufiri maksimal i pranimit të zhurmës për kohën e orëve të natës prej orës 23⁰⁰ – 6⁰⁰.

Sa më sipër konstatohet se në të gjitha rastet e audituara, është tejkalluar niveli 30-45 dB(A) gjatë natës, i cili është kufiri maksimal i pranimit të zhurmës për kohën e orëve të natës, prej orës 23⁰⁰ – 6⁰⁰, veprime këto në kundërshtim me:

- Ligjin nr. Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 10, Oraret,

-Udhëzimin MMPAU dhe MSH Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”, aneksi 1, “Mbi kufijtë e zhurmave, sipas orëve të ditës,

-Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë”, pikat 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në **65 dosje**, për vitin 2015, lidhur me gjenerimin e zhurmave në mjedis për aktivitetet e tjera në zona të banuara, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë”, shtojca I, konstatohet se, përveç rastit të lokaleve të natës, veprimtaritë e specializuara të argëtimit që gjenden në zonat e banuara, *në asnjë rast tjetër nuk është proceduar nga ana e ISHP-së me hartimin e raporteve për nivelet e pritshme të zhurmës që do të çlirohen në mjedis nga veprimtaritë e tjera të cilat gjenerojnë zhurma në mjedis*.

Në proces-verbalet e komisioneve dhe aktet e miratimit të cilët janë hartuar formalë, nuk është reflektuar mbi nivelin e zhurmave që gjenerohen nga këto 62 subjekte, mosveprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 10.

-Udhëzimin MMPAU dhe MSH Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”, aneksi 1, “mbi kufijtë e zhurmave, sipas orëve të ditës.

-Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë”, pikat 5,6,7,8,9,10,11 dhe shtojca I (*Trajtuar në faqet 95-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në DRM, Qarku Tiranë, për shkarkimet e ngurta nuk aplikohen norma sipas lejeve mjedisore të lëshuara deri tani, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10 dhe me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 101-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në 17 raste, për vitin 2015, mungojnë kërkesat në formë dixhitale që duhej të ishin dorëzuar nga aplikuesit/kërkuesit, mosveprim në kundërshtim me pikat 2,3,4,5, Kreu IV, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 99-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në të gjitha rastet, nga DRM Tiranë është dhënë mendim për leje të tipave “A” dhe “B” dhe për VNM, në një kohë që për të gjitha rastet, në dosjet disponibël, praktikën dokumentare dhe në sistemin elektronik, nuk janë dhënë argumentet përkatëse në favor të mendimeve pozitive dhe negative, por vetëm janë paraqitur formalisht vendimet për mendime pozitive apo negative (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në dosjet e refuzuara për dhënie leje mjedisore të tipit “C”, nuk janë dhënë argumentet përkatëse për refuzimet e bëra në akt-refuzimet dhe informacionet përkatëse shpjeguese, lidhur me dosjet e refuzuara janë të panëshkruara nga komisionet, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishtme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Kreu IV “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit “C”, pika 5.

- Për refuzimet e komisionit II, mungojnë akt-refuzimet (periudha e audituar Shtator-Nëntor 2015), veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, Kreu IV “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit “C”, pika 5 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit nuk ka marrë masa për revokimin e lejeve për 10 subjektet debitorë në vlerën 3,020,000 lekë.

për subjektet e gjobitura nga ISHM, për të cilat konstatohet se nuk janë të dhënat e plota, nuk ka kërkuar në rrugë shkresore ISHM-së, të dhënat e plota me të gjitha modalitetet që përmban procesverbali, si numrin e vendimit të gjobës, subjekti, numrin e serisë së mandatit të gjobës, data, shuma, adresa, arsyeja e gjobës, nëse kanë shlyer gjobën dhe të marrë masa dhe nuk ka krijuar një “database” të veçantë, e cila të përdoret në rastin e revokimit të lejeve mjedisore (*Trajtuar më hollësisht në faqet 84-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C/2. Nga “Vërejtje” deri në “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, për këta punonjës:

1. **T.M** në cilësinë e specialistit vlerësimit
2. **E.Sh** në cilësinë e specialistes vlerësimit
3. **Sh.H** në cilësinë e specialistes vlerësimit
4. **I.S** në cilësinë e specialistes vlerësimit
5. **B.M** në cilësinë e specialistit vlerësimit
6. **L.H** në cilësinë e specialistes vlerësimit
7. **A.B** në cilësinë e specialistit vlerësimit
8. **A.T.** në cilësinë e specialistes vlerësimit
9. **B. H** në cilësinë e specialistes vlerësimit
10. **F.M** në cilësinë e specialistes vlerësimit
11. **M. A** në cilësinë e specialistes vlerësimit

Për të meta e mangësi të konstatuara në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për vlerësimin dhe dhënien e lejes së mjedisit të tipit C të subjekteve të trajtuara prej tyre. Konkretisht janë dhënë leje pa plotësuar dokumentet si:

- Vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve në mënyrë të veçantë atë to listuara në shtojcën 2 të ligjit nr. 10 448, datë 14.07.2011
- Dokumentin që operatori të informojë rregullisht njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, DRM përkatëse dhe njësinë e Inspektoriatit Shtetëror për Mjedisin të Qarkut mbi të dhënat e vetmonitorimit.
- Dokumentin për deklarimin e veprimeve për mbetjet e ngurta (llumrat e depozitave) që gjenerohen gjatë zhvillimit të veprimtarisë.Në rastet kur deklarojnë nuk kanë kontrata të lidhura me bashkinë për mënyrën e asgjësimit të mbetjeve.Në çdo rast duhet të shoqërohet me lejen e bashkisë për vend hedhjen e mbeturinave, transportin, groposjen etj.
- Në aplikime mungon dokumenti i vërtetimit nga Inspektoriati Qëndror Teknik referuar ligjit "Për Emergjencat Civile
- Trajtimi i kërkesës së aplikuesit dhe dokumentacionit të paraqitur prej tyre, nuk është arkivuar në rrugë shkresore ose elektronike për dhënien e mendimit të tyre,
- Nuk ka dokument përmbledhës (Procesverbal) të firmosur nga antarët e grupit për rezultatet e shqyrtimit të kërkesës dhe dhënien e mendimit për miratim ose jo të lejes.
- Nuk janë zbatuar kërkesat e kreut të IV-të ligjit nr. 419, datë 25.06.2014 pika 2 dhe 3 e vendimit 419, datë 25.06.2014, ku citohet se brenda 3 ditëve punë nga data e marrjes së aplikimit, DRM dërgon një kopje të aplikimit në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV), e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda 3 (tre) ditëve pune.
- Për mos zbatim të shkresës nr. 148, datë 06.10.2014, bazuar në nenin 11 “Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit” detyrë e lënë edhe nga auditimi i KLSH, në zbatim të ligjit nr. 10431, datë 14.07.2011, “Për Mbrotjen e Mjedisit”, nuk ka dokumenta për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera si Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujrave, (ISHMPU), Agjensia Kombëtare e Mjedisit
- Në **230 dosje** të audituara për vitin 2015, kërkesat (aplikimet) e operatorëve për leje të tipit “C” dhe mendimet për VNM për lejet e tipeve “A” dhe “B”, vijnë në rrugë elektronike nga QKL-ja, nuk është nxjerrë ndonjë akt ligjor apo nënligjor për regjistrimin elektronik në rastin e përcjelljes së kërkesave në DRM Qarku Tiranë,duke mos zbatuar VKM 419, datë 25.06.2014,për përcjelljen nga AKM (Agjencia Kombëtare e Mjedisit) në ARM Qarku Tiranë.
- Mos mbajtjen e dokumentacionit shkresor dhe jo vetem elektronik pasi kalimi nëpërmjet rrugës elektronike, nuk garanton siguri për të dhënat e përcjella nga QKL, të cilat na u paraqitën në një folder të kopjuar. veprime në kundërshtim me pikën “2”, të Kreut IV, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 dhe me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Titulli III *(Trajtuar më hollësisht në faqet 84-100, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.
- **Hatimin formal të** akteve të miratimit të lejeve dhe proces-verbalet e komisioneve.Në to nuk ka të dhëna të detajuara dhe të hollësishme për shkarkimet në mjedis, sipas shtojcës 2, tabela: “Lista indikative e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh nqs kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve”, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, si pjesë e kushteve për dhënien e lejes së mjedisit tipi “C”, e përcaktuar si kërkesë bazuar në VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10 dhe në VKM nr. 435, datë 12.9.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”. Në Aktet e miratuara për lejen e mjedisit të tipit “C”, për çdo instalim, nuk janë shënuar sipas rastit, *vlerat kufi të shkarkimit të ndotësve, që parashikohen të shkarkohen në sasi të konsiderueshme nga instalimi.* Vlerat kufi të shkarkimeve, sipas rastit, mund të zbatohen për grupe ndotësish dhe jo për ndotës të veçantë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 100-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

- Në **21 raste**, për vitin 2015, aktet e miratimit nuk janë hartuar duke përcaktuar kushtin “7”, të formatit të këtij akti, për komponentin mjedisor: “Zhurmat”, mbi bazën e verifikimeve përkatëse dhe konkluzioneve përfundimtare, sipas ekspertizës së kryer nga ISHP-ja (Insituti i Shëndetit Publik). Në të gjitha rastet **është tejkuluar niveli 30-45 dB(A) gjatë natës, i cili është kufiri maksimal i pranimit të zhurmës për kohën e orëve të natës, prej orës 23⁰⁰ – 6⁰⁰**, veprime këto në kundërshtim me:
 - Ligjin nr. Nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 10, Oraret,
 - Udhëzimin MMPAU dhe MSH Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, aneksi 1, “Mbi kufijtë e zhurmave, sipas orëve të ditës,
 - Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë”, pikat 5, 6 ,7, 8, 9, 10, 11 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- Në **65 dosje**, për vitin 2015, lidhur me gjenerimin e zhurmave në mjedis në proces-verbalet e komisioneve dhe aktet e miratimit nuk është reflektuar mbi nivelin e zhurmave që gjenerohen nga këto 62 subjekte, mosveprim në kundërshtim me:
 - Ligjin nr. Nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 10.
 - Udhëzimin MMPAU dhe MSH Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, aneksi 1, “mbi kufijtë e zhurmave, sipas orëve të ditës.
 - Udhëzimin nr. 5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë”, pikat 5,6,7,8,9,10,11 dhe shtojca I (*Trajtuar në faqet 95-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- Në të gjitha rastet, për vitin 2015, për shkarkimet e ngurta nuk aplikohen norma sipas lejeve mjedisore të lëshuara, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 10 dhe me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 101-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- Në **17 raste**, për vitin 2015, mungojnë kërkesat në formë dixhitale që duhej të ishin dorëzuar nga aplikuesit/kërkuesit, edhe këto të kopjuara në disk, mosveprim në kundërshtim me *pikat 2,3,4,5, Kreu IV, të VKM nr. 419, datë 25.06.2014. (Trajtuar më hollësisht në faqet 99-115, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.
- Në të gjitha rastet, nga DRM për lejet të tipave “A” dhe “B” dhe për VNM, në dosjet disponibël, praktikën dokumentare dhe në sistemin elektronik, nuk janë dhënë argumentet përkatëse në favor të mendimeve pozitive dhe negative, por vetëm janë paraqitur formalisht vendimet për mendime pozitive apo negative (*Trajtuar më hollësisht në faqet 110-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- Në dosjet e refuzuara për dhënie leje mjedisore të tipit “C”, nuk janë dhënë argumentet përkatëse për refuzimet e bëra në akt-refuzimet dhe informacionet përkatëse shpjeguese,veprime në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Kreu IV “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit “C”, pika 5.
- Për refuzimet e komisionit II, mungojnë akt-refuzimet (periudha e audituar Shtator-Nëntor 2015), veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.06.2014, Kreu IV “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të tipit “C”, pika 5 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90-120, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C/3.PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

Masa disiplinore e rekomanduar do të ishte *“Largim nga shërbimi civil”, neni 58, germa “ç”*, pasi shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërmendur nuk janë në marrëdhënie pune dhe nuk kanë adresim institucional për dhënien dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Në kushtet kur mosushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre ka ndikuar në funksionimin administrativ të institucionit, ngarkohet DRM- Tiranë të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH për personin e mëposhtëm dhe marrjen e masave të mëtejshme ndaj saj:

1. J.S. me detyrë ish-specialiste e monitorimit në vitin 2014-2015, pasi nga auditimi janë konstatuar të meta e mangësi në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për vlerësimin dhe dhënien e lejeve të mjedisit të tipit C (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R